

EDMOND MALAJ

Instituti i Historisë/ Akademia e Shkencave e Shqipërisë
edmond.malaj@asa.edu.al

**PËRPPJEKJET E PARA TË BALSHËS III DHE TË NËNËS SË TIJ,
HELENËS, PËR MARRJEN E SHKODRËS ME RRETHINA NË
FILLIM TË SHEK. XV****Abstrakt:**

Në artikullin e mëposhtëm paraqitet një pjesë e shkurtër e historisë së Shkodrës mesjetare, që ka të bëjë me kalimin e këtij qyteti me rrethina nën sundimin venedikas, të realizuar nga vetë Gjergj II Strazimir Balsha dhe më pas, përpjekjet që bënë qoftë Gjergji vetë, qoftë i biri i Gjergjit, Balsha III me të ëmën, Helena Balshën, për rivendosjen nën sundimin e tyre të këtyre trojeve. Përpjekjet e Balshës përqendrohen në dy pika kulminante që janë: 1. kryengritjet ndaj venedikasve dhe lufta e Balshës III gjatë viteve 1404-1405, e cila në disa studime njihet edhe si Lufta e Parë e Balshës III për Shkodrën dhe 2. ngjarjet e vitit 1418, gjatë të cilave Balsha III me të ëmën përpiqen sërish që t'ua marrin Shkodrën venedikasve. Këto ngjarje hasen edhe me përcaktimin si Lufta e Dytë e Balshës III për marrjen e Shkodrës. Artikulli i mëposhtëm ka si objekt studimi pikërisht ngjarjet e viteve 1404-1405 dhe ka si kornizë kohore periudhën nga viti 1392, kur Gjergj II Strazimir Balsha detyrohet t'ua lëshojë turqve përkohësisht Shkodrën dhe Ulqinin, e vazhdon deri në vitin 1411, kur Balsha III bën paqe me venedikasit, pasi shuhen kryengritjet dhe përpjekjet e tij për të marrë Shkodrën me rrethina.

Fjalë kyçe:

Gjergj II Strazimir Balsha, Balsha III, Helena Balsha (Lzaeviq), Shahini, osmanët, venedikasit, Shkodra, Drishti, Lezha, Ulqini, Tivari.

Në vend të parathënies

Me përpjekjet e lartpërmendura të viteve 1404-1405 nënkuptohen planet dhe veprimet që bënë konkretisht Balsha III dhe nëna e tij, Helena (ose Jelena), për t'ua marrë edhe një herë venedikasve Shkodrën me rrethina gjatë viteve 1404-1405, pasi këto ua kishte dhënë më parë atyre Gjergj II Strazimir Balsha. Luftërat e Balshajve në lidhje me këtë çështje janë cekur edhe nga studiuesit shqiptarë më përpara, më saktë gjatë periudhës së sundimit të diktaturës komuniste. Qasja e tyre ka qenë e indoktrinuar nga politika e shtetit komunist në pushtet dhe nga “filozofia marksiste-leniniste”,¹ dhe siç dihet, produkti i dalë nga historiografia shqiptare gjatë asaj periudhe, që cilësohet si “historiografia jonë e re marksiste-leniniste”,² shpeshherë ka probleme të mëdha, jo vetëm për sa i përket historisë së shek. XX, por edhe të asaj mesjetare.

Pra, lind nevoja që një temë e tillë të rishikohet edhe një herë duke u bazuar kryesisht në dokumente, por edhe te studiues të huaj sidomos te Gelçiq, Jireçek dhe Ljubiq etj., pra në literaturën historiografike të huaj, e cila në periudhën e lartpërmendur konsiderohej në mënyrë nënvlerësuese, si gjoja e mangët dhe që nuk jepte përgjigje të kënaqshme, por edhe që jepte “interpretime të gabuara” duke u nisur “nga një bazë metodologjike idealiste subjektiviste dhe nga qëllime antishqiptare”.³ Megjithatë, nuk do të lëmë pa cituar edhe autorët shqiptarë, duke paraqitur një sintezë të rezultateve të tyre me të dhënat e dokumenteve dhe të autorëve të huaj.

¹ Në një artikull të tij të botuar në vitin 1980 dhe ribotuar në vitin 1989, pikërisht për Balshajt dhe për këtë çështje që po marrim në shqyrtim Luan Malltezi shkruan: “*Historiografisë sonë i bie detyra ta trajtojë për së mbari, nën prizmin e filozofisë marksiste-leniniste këtë luftë, që përbën për shumë arsye një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë politike të Shqipërisë Veriore në 20 vjetët e parë të shek. XV*”. Luan Malltezi, “Shkaqet e luftës së Balshës III kundër Republikës së Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV”, në *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1989), 176; shih po të njëjtin artikull me të njëjtin titull te revista: *Studime historike*, nr. 2 (1980): 179. Në këtë punim do të merret parasysh artikulli i botuar në revistën *Studime historike*.

² Pranvera Bogdani, “Lufta kundër Venedikut për çlirimin e krahinës së Shkodrës dhe të qyteteve të saj në fund të vitit 1404 – mesi i vitit 1405”, në *Studime për Epokën e Skënderbeut*, vëll. II, 198; shih po të njëjtin artikull me të njëjtin titull te revista *Studime historike*, nr. 2 (1983): 152.

³ Po aty.

Ngjarje pararendëse

Para se të marrim në shqyrtim këtë ngjarje, ia vlen të sqarojmë se përse venedikasit e shtinë në dorë Shkodrën në vitin 1369. Në dekadën e fundit të shek. XIV, turqit kishin filluar sulmet në drejtim të Adriatikut dhe nga ato u prekën edhe zotërimet e Balshajve.⁴ Në atë kohë, Gjergj II Strazimir Balsha e kishte selinë e tij në Ulqin, dhe ngaqë po e shihte se nuk mund t'u bënte ballë turqve, i pati kërkuar ndihmë Papë Bonicafit IX, duke caktuar kështu si trashëgimtare të zotërimeve të tij kishën romane në rast se do të vdiste pa bij legjitimë.⁵

Sipas Jireçekut, një vit më vonë, pra më 1392, duket se Gjergj Strazimiri kishte pasur kontakt me osmanët me qëllim që të zhvillonte bisedime, por gjatë kësaj kohe ishte mbajtur rob së bashku me kushëririn e tij, Konstandin Balshën (*dominum Georgium Strazimir et quendam eius consanguineum retentos fuisse a Baysith bey*)⁶, dhe që të fitonte sërish

⁴ Konstantin Jireček, *Historia e serbëve*, Pjesa e dytë (Gjysma e parë 1371-1537), përktheu nga gjermanishtja Elda Gjana-Boriçi (Tiranë: Shtëpia Botuese "55", 2010), 156.

⁵ "[...] *Exhibita siquidem nobis nuper pro parte tua petitio continebat, quod tu ex devocionis fervore deliberato animo desidera, et proponis tam personam tuam ac filios tuos, si quos te habere contigerit, quam etiam omnes civitates, terras, necnon castra et loca tue ditioni subiecta, Romane ecclesie ac nobis et successoribus nostris Romanis Pontificibus canonice intransibibus subicere, et immediate nobis et successoribus ac ecclesie predictis subesse vis et consentis, et in casu, quo te absque filiis legitimis et naturalibus ex tuo corpore descendentibus decedere contingeret, tue intencionis et voluntatis existit, quod predicta Romana ecclesia in civitatibus ac terris, necnon castris et locis aliis ad te per tinentibus tibi succedat, et illorum dominium libere ad eandem ecclesiam perveniat, et sic propria sponte et ex tua mera liberalitate nobis tua nobilitas offerre curavit. [...]. Ex Reg. orig. An. II. litt. div. lib. II. fol. 103.*" Augustino Theiner, *Vetera monumenta historica Hungariam Sacram illustrantia. Maximum partem nondum edita ex tabularis vaticanis*. Deprompta collecta ac serie chronologica desposita ab Augustino Theiner. Tomus Secundus ab Innocentio PP VI usque ad Clementem PP. VII. 1352-1526 (Romae: Typis Vaticanis MDCCCLX, nr. CCCXXIV, 1860), 165-166; shih edhe: Constantin Jireček, *Geschichte der Serben. Zweiter Band, erste Hälfte (1371-1537)* (Gotha: Driedrich Andreas Perthes A.-G., 1918), 156.

⁶ Sime Ljubić, *Listine o odnošajih između južnoga Slavenstva i mletačke republike*. Na sviet uzdaje Jugoslavenska Akademija Znanosti i umjetnosti, Skupio Sime Ljubić, Knjiga IV (Do godine 1358 od 1403) (U Zagrebu: Albrechta i Fiedlera 1874), nr.

lirinë ai kishte qenë i detyruar që t'u lëshonte turqve dy qytetet kryesore të tij, Ulqinin dhe Shkodrën⁷ dhe më pas edhe Shën Shirqin. Për këtë dëshmojnë dy dokumente të datave 7 tetor 1392⁸ dhe më 16 korrik 1394, në të cilat në mënyrë indirekte mësojmë që administratori turk Shahini ishte bërë zot i atij limani në Shën Shirq,⁹ i cili qëndroi në Shkodër për dy vjet (1393-1395). Për sa i përket pushtimit të qytetit të Ulqinit nga turqit, një gjë e tillë nuk mund të konfirmohet,¹⁰ edhe pse dokumenti i sipërcituar e përmend si marrëveshje.¹¹ Më pas, në vitin 1395, Gjergj Strazimir Balsha arriti ta dëbonte Shahinin nga Shkodra dhe ta rimerrte edhe një herë qytetin me lokalitete përreth.¹² Për këtë na dëshmon në mënyrë indirekte një dokument venedikas i datës 4 mars 1400,¹³ kur tashmë Shkodra ishte në duart e venedikasve.

Gjergj II Strazimiri nuk ishte në gjendje ta mbante Shkodrën më tej nën dominimin e tij, sepse ishte i kërcënuar vazhdimisht nga turqit. Kështu, gjatë vitit 1395, u bënë bisedime të ndryshme ndërmjet të dërguarve të Gjergj Strazimitrit¹⁴ dhe në prill të vitit 1396 ai ia lëshoi Republikës së Venedikut qytetin e Shkodrës me rrethina së bashku me

CCCCXXV, 296. (Më tej cituar: Ljubić, *Listine 4*, nr.); shih edhe: Jireček, *Geschichte der Serben 2*, 157.

⁷ Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, ed., vol. II, München-Palermo-Milano: 1967, nr. 455 (më tej: AAV, II, nr.).

⁸ “[...] *Capta: cum propter nova, que habentur multis modis et viis de retentione domini Dulcigni et cuiusdam consanguinei sui facta per Baysith Turchum, et de conventionibus factis inter dictum Turchum et dictos do minos, videlicet de dando et ponendo Dulciguum et Scutari ac alia loca sua sub potentia et dominio dicti Baysith pro liberatione et relaxatione eorum, omnino sit providendum super hoc [...]*”, Ljubić, *Listine 4*, nr. CCCCXXV, 295-296.

⁹ “1394. *indictione secunda, die XVI iulii. [...] habent etiam certa pacta cum Sayno Turcho, domino mercati sancti Serci, et illi datur de sale Durachii secundum usum, et si non daretur sibi, ipse non permetteret aliquas caravanas nec aliquem alium venire Durachium,*” Ljubić 1874, *Listine 4*, nr. CCCCLXIX, 330.

¹⁰ Malltezi, “Shkaqet e luftës së Balshës III”, 1980, 187.

¹¹ AAV II, nr. 455.

¹² Jireček, *Geschichte der Serben*, 161.

¹³ “[...] *dictus dominus Georgius dedit primo dicto Sayno Turcho locum Scutari, et postea illum eidem surripuit, et postea illum dedit nostro dominio, de quo dictus Saynus non bene contentus, pretendens ius habere in eodem loco, nunquam cessabit inferre molestias et gravitates contraere, nisi aliud remedium apponatur; [...]*”. Ljubić, *Listine 4*, nr. DXCIII, 427.

¹⁴ *Po aty*, nr. D, 350-351.

Drishtin¹⁵ me krahina përreth, më tej kështjellën e Satit me doganën e Dëjës me të gjitha fshatrat dhe të gjithë krahinën në lindje të Liqenit të Shkodrës me ishujt brenda tij, më pas krahinën e Tejbunës deri në det.¹⁶ Si shpërblim nga ky dorëzim duhej të merrte një shumë prej 1 000 dukatesh në vit dhe, sipas P. Bogdanit të ruante të drejtën e kryezotit ndaj pronarëve të krahinës, kur të kishte nevojë për të drejtat e tyre.¹⁷ Ndërsa si territore për vete, për gruan e tij dhe për trashëgimtarin e tij, ai mbajti Ulqinin me rrethina dhe Tivarin me rrethina e me sipërfaqen malore deri në bregun perëndimor të liqenit dhe territori i tij në Jug shtrihej deri në bregun e Bunës në të ashtuquajturën krahinë të Zabojanës (Tejbunës), duke vazhduar në perëndim deri në breg të detit.¹⁸ Pra, lumi Buna vlente si një kufi natyror ndërmjet Principatës së Balshajve dhe zotërimeve të Venedikut. Nuk kaloi shumë kohë dhe kërcënimi turk për Shkodrën me rrethina u bë përsëri shumë i ndjeshëm. Në vitin 1399 shpërtheu një kryengritje që përfshiu krahina të tëra që ishin nën administrimin venedikas, si Durrësin, krahinën e Shkodrës dhe Drishtin që u çliruan përkohësisht në shtator të atij viti.¹⁹

Popullsia e krahinës së Shkodrës që ishte çuar në kryengritje kishte plaçkitur magazinat e kripës në Shën Shirq dhe i kishte detyruar

¹⁵ *Po aty*, nr. DXII, 362-363.

¹⁶ *“Primo quidem, quod ipse magnificus dominus Georgius Stracimeri, dominus Zente, dare debeat ipsi serenissimo domino duci et communi Venetiarum seu habentibus ab eis arbitrium et potestatem ipsa loca accipiendi et acceptandi, civitatem Scutari cum castro suo et cum omnibus in troitibus, dohanis, datiis, pedagiis et gabellis tam sancti Sergii quam aliis ad ipsam civitatem spectantibus et cum toto lacu et insulis in eo existentibus et secundum quod labitur flumen, quod Boiana vulgariter nun cupatur, usque ad marinam. Item dare debeat ipsi domino duci et communi Venetiarum aut illis, qui per ipsos ad hoc fuerint deputati, civitatem Drivasti cum castro et pertinentiis suis, et castrum Satti cum dohana del Dagno et cum omnibus villis, dohanis, introitibus, pareziis et datiis et cum tota contracta, secundum quod posita est et continet a bucha dicti fluminis sursum, cum tota aqua et apud vel iuxta, saltem cum tota contrata, secundum quod posidet ad presens et posidebat ipse dominus, quando inceptum fuit tractari de factis istis.”* *Po aty*, nr. DXIV, 366-367.

¹⁷ Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 160; shih edhe AAV II, nr. 611.

¹⁸ *“Reservante eo sibi, magnifice uxori sue et suis heredibus civitatem Dulcigni cum toto suo districtu, et similiter Antivarum cum tota contrata usque divicinani stiena et ita supra per montes, confinando cum altera ripa lacus, et ita infra ab altera parte Aluminis per ripam dicti fluminis usque ad marinam, que tota patria vulgo dicitur Saboiana.”* Ljubić, *Listine 4*, nr. DXIV, 367.

¹⁹ Qerim Dalipi, *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355-1443)* (Tetovë: ARS-ZZ 2012), 189.

venedikasit të tërhiqeshin në kështjellat e Shkodrës dhe të Drishtit, dhe si rrjedhojë konti venedikas i Shkodrës, Nikolla Polani, në shtator të po atij viti i kërkoi Sinjorisë që t'i dërgonte shigjetarë, të cilët u dërguan në Shkodër më vonë me një vendim të dytë, e që përbënin një grup prej 20 vetash.²⁰

Sipas Q. Dalipit, shkaqet e kësaj kryengritjeje antivenedikase ishte paaftësia e Republikës për të mbrojtur krahinën e Shkodrës, por edhe inkursionet plaçkitëse të osmanëve mbi viset e Shkodrës dhe të Drishtit.²¹ Këto inkursione vazhduan edhe gjatë vitit 1400, dhe në qershor të po këtij viti Republika informohej, se “osmanët u kishin shkaktuar qytetarëve rrënimin e drithërave, të vreshtave dhe gjërave të tjera jashtë mureve dhe se në Venedik ishte krijuar bindja se qyteti i Shkodrës dhe i Drishtit vështirë se mund të mbahen gjatë gjithë kohës nën zotërimin tonë nga shkaku i trazirave të vazhdueshme të turqve.”²² Gjatë vitit 1400 dokumentohet edhe një djegie e Shkodrës, pikërisht nga hordhitë osmane.²³

Me të kaluar këto probleme të shkaktuara nga inkursionet grabitëse të osmanëve me në krye Shahinin, lëvizjet kryengritëse shpërthyen përsëri në Shkodër e rrethina, mirëpo kësaj here protagonistë kryesorë të tyre nuk ishin turqit por vetë Gjergj II Strazimir Balsha.²⁴ Sikur të mos mjaftonin këto probleme krahinat e Shkodrës, të Drishtit dhe të Lezhës patën edhe një fatkeqësi tjetër. Në maj të vitit 1401 në këto vende depërtoi murtaja, dhe sidomos në Shkodër e në Drisht bëri kërdrinë deri në qershor të atij viti,²⁵ “duke i katandisur këto qytete në një gjendje të mjerueshme, saqë nuk qenë në gjendje t'i bënin ballë asnjë lloj goditjeje, qoftë edhe nga një agresor i dobët.”²⁶

Tani, për sa i përket qëndrimit të tij jo fort miqësor ndaj Venedikut që mbajti Gjergj II Strazimir Balsha në vitet e fundit të jetës së tij, ka shumë shpjegime të ndryshme. Giuseppe Valentini është i mendimit që,

²⁰ *Po aty*, 189-190.

²¹ *Po aty*, 190.

²² *Po aty*.

²³ ASV, Grazie R°19/25, cituar sipas: Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 165, ref. 117.

²⁴ Dalipi, *Arbëria midis Republikës*, 190.

²⁵ Sipas Bogdanit në vitet 1401-02: ASV, Del Mistre Sen XLV/ 94/95v. XLVI 17 (18), në Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 165, ref. 117.

²⁶ Giuseppe Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, përktheu nga origjinali Laura Leka (Tiranë: Shtëpia Botuese “55”, 2009), 237.

Gjergj II Strazimir Balsha, pasi ua dorëzoi një pjesë të territoreve të tij venedikasve, “mbeti një fqinj i keq për Venedikun duke i shkaktuar shqetësime, sepse ose qe penduar, ose, duke vepruar kështu, donte ta detyronte Sinjorinë, për t’i shkëputur më shumë fitime.”²⁷ Luan Malltezi jep një tjetër shpjegim në lidhje me shkaqet e këtij qëndrimi. Me rënien e presionit turk pas Betejës së Ankarasë (1402), ishte mënjanuar tashmë edhe rreziku turk dhe si rrjedhojë, “ishte fare e natyrshme që edhe qëndrimi i Gjergjit II ndaj Sinjorisë të ndryshonte, në përputhje me interesat e zotërimit të tij. Me këtë shpjegohet para së gjithash afrimi dhe largimi i Gjergjit II nga Sinjoria, i cili në përshtypjen e parë duket si qëndrim kontradiktur. ... Fjala ishte për interesa themelore të principatës dhe princi shqiptar nuk mund të mos ishte shumë i matur, sidomos ndaj Sinjorisë, e cila përbënte një rrezik shumë të madh për principatën.”²⁸

Përveç rrezikut turk tashmë të zvogëluar, si shkak i betejës së sipërpërmendur, për Gjergj II Strazimir Balshën ishte mënjanuar edhe një rrezik tjetër që mund t’i vinte nga kushëriri i tij, Konstandin Balsha, i cili qe ekzekutuar nga venedikasit në Durrës (*quondam Constantini, iustificati in Durachio*)²⁹ dhe kjo e bënte Gjergjin edhe më të sigurt për këmbënguljen në kërkesat e tij. Sipas Q. Dalipit, “implikimi i Gjergjit në kryengritje mund të shihet si rrjedhojë e pakënaqësisë së tij ndaj politikës diskriminuese të Republikës që zbatonte me të nënshtuarit e tij të dikurshëm; paaftësisë së saj për të përballuar inkursionet plaçkitëse osmane si dhe si përpjekje për të nxitur Republikën që me vendosmëri më të madhe t’i përkushtojë zgjidhjes së problemeve të përmendura, ngaqë në të kundërtën lihej të kuptohej se nuk kishte hequr dorë nga zotërimet që ia kishte lëshuar.”³⁰

Gjergj II Strazimir Balsha u sëmur qysh në dhjetor të vitit 1402 dhe filloi që të mos ta ndiente veten mirë dhe në mars të vitit 1403 gjendja e tij u përkeqësua aq shumë, saqë mjekët raguzanë që po e kuronin nuk

²⁷ Giuseppe Valentini, “Appunti sul regime degli stabilimenti veneti in Albania nel Secolo XVI e XV”, në *Studi Veneziani* VIII-1966 (Estratto). Cituar sipas: Malltezi, “Shkaqet e luftës së Balshës III”, 1980, 182.

²⁸ Malltezi, “Shkaqet e luftës së Balshës III”, 1980, 185.

²⁹ *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, nr. 709. (Në vijim cituar si: *AAlb.* II, nr.)

³⁰ Dalipi, *Arbëria midis Republikës*, 191.

kishin se çfarë t'i bënin më.³¹ Kështu raguzanët Nalco dhe Marino Giorgi u nisën më datë 18 prill 1403 urgjentisht në drejtim të Ulqinit, me qëllim që t'i shprehnin ngushëllimet e tyre të vesë së tij, Helena Balshës, për vdekjen e Gjergj Strazimir Balshës, i cili vdiq si “mik i mirë e ngushtë” i Republikës së Raguzës.³²

Kush ishin Balsha III dhe e ëma e tij, Helena Balsha (Lazareviq)

Gjergj II Strazimir Balsha la pas një djalë të vetëm, Balshën III, por edhe problemet që kishin mbetur pezull me Venedikun. Tek i biri u trashëgua gjithashtu edhe dëshira për t'i shtënë në dorë edhe një herë ato territore që Gjergji ua kishte dhënë venedikasve vite më parë. Në lidhje me Balshën III mund të themi se ishte në moshën 17-vjeçare kur i vdiq i ati, dhe se duhet të ketë lindur diku në territorin e Zetës në vitin 1386. Ai u lidh nëpërmjet martesës edhe me familjen fisnike Topija ngaqë, sipas Ljubiqit, ishte martuar me të bijën e Gjergj Topisë,³³ ndërsa sipas Pranvera Bogdanit, me të bijën e Niketë Topisë.³⁴

Ai ishte biri i vetëm që i kishte mbetur Gjergj II Strazimir Balshës, pasi dy djem të tjerë i kishin vdekur, kur ai ishte ende gjallë.³⁵ Për sa u përket marrëdhënieve me venedikasit, ai i qëndroi armik Republikës së tyre gjatë gjithë jetës dhe në përpjekjet kundër venedikasve, për të shtënë në dorë edhe një herë territoret që u kishte dhënë i ati, ai u ndihmua nga daja i tij Stjepan Lazareviq, nga tezja e tij Mara, gruaja e të ndjerit Vuk Braknoviq, por edhe nga duka boshnjak Sandalj Hranic, me të cilin u

³¹ Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, 240.

³² *Po aty*.

³³ Sime Ljubić, *Opis Jugoslavenskuh Novaca*. Od Prof. Sim Ljubića. Izdanje Umnoženo (Zagreb: Artističko-Tiopografičku Zavod Dragutina Albrechta 1875), 184.

³⁴ Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 153.

³⁵ Mavro Orbini, *Il Regno degli Slavi hoggi corrottamente detti Schiavoni*. Historia di Don Mavro Orbino Rauseo Abbate Melitense. Nella qualesi vede l'Origine quasi di tutti i Popoli, che furono della Lingua Slava, con molte, & varie guerre, che fecero in Europa, Asia, & Africa; il progresso dell'Impero, l'antico culto, & il tempo della loro conversione al Christianesimo. E in particolare veggonsi i successi de'Rè, che antocamente dominarono in Dalmatia, Croatia, Bosna, Servia, Rassia, & Bvlgaria. In Pesaro, Appresso Girolamo Concordia. Con Licenza de'Superiori. M.DCI (Pesaro: 1601), 294.

martua nëna e tij në vitin 1412.³⁶ Si karakter ishte kryeneç dhe nuk i kishte qejf zgjidhjet e problemeve me diplomaci dhe u përpoq gjatë gjithë jetës së vet të largonte venedikasit nga territoret e tij. Ai vdiq në vitin 1421, ndoshta nga një vdekje e panatyrshme.³⁷ Në lidhje me vdekjen e tij thuhet se ai i sëmurë rëndë, shkoi në oborrin e dajës së tij, despotit serb Stefan Lazareviq, ku, sipas Lajçit, vdiq më 26 prill 1421,³⁸ por sipas Millutinoviqit më 28 prill 1421.³⁹

Kurse Ruvarac-i dhe Giuseppe Gelcich janë të një mendimi tjetër. Ruvarac-i shkruan që Balsha III më 28 prill 1421 është dokumentuar si i gjallë dhe në një dokument të datës 3 korrik të po atij viti ai përmendet si i vdekur, pra data e tij e vdekjes duhet të jetë midis 28 prillit dhe 3 korrikut të vitit 1421.⁴⁰ Gelcich-i është i mendimit se Balsha III vdiq në qershor të vitit 1421,⁴¹ në besimin ortodoks,⁴² ashtu siç ishte edukuar dhe rritur nga ëma serbe, e cila vdiq më vonë si ortodokse. Ai nuk pati pasardhës mashkull, por vetëm tri bija, të cilat u rritën nën përkujdesjen e gjyshes së tyre Helenës dhe të Sandalj Hraniqit.⁴³ Njërën vajzë ai e kishte pasur me sa duket me gruan e parë që kishte qenë nga dera e Topiajve, ndoshta e bija e Gjergj Topisë,⁴⁴ e cila ose ishte ndarë nga jeta, ose ishte divorcuar për shkak se nuk kishte lindur pasardhës meshkuj.⁴⁵ Kurse dy të voglat, të cilat kur vdiq Balsha ishin akoma të mitura,⁴⁶ Balsha duket i

³⁶ Ljubić, *Opis Jugoslavenskuh Novaca*, 184.

³⁷ *Po aty*.

³⁸ Lulëzim Lajçi, *Shkodra në shekullin XV* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997), 85.

³⁹ Branislav Millutinoviq, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, në *Gjurmime Albanologjike*. Seria e shkencave historike 15-1985 (1986), 54.

⁴⁰ Hilarion Ruvarac, “Zwei bosnische Königinnen”, në *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der Herzegovina*. Herausgegeben vom Bosnisch-Hercegovinischen Landesmuseum in Sarajevo. Redigiert von Dr. Moriz Hoernes. Dritter Band. Mit 16 Tafeln und 1178 Abbildungen im Texte. (Wien: 1895), 374.

⁴¹ Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, 362.

⁴² Ruvarac, “Zwei bosnische Königinnen”, 377.

⁴³ Kjo vërtetohet sipas një dokumenti të datës 3 shtator 1425: “*Cum sit [Sandalj]cum dictis dominis affinitate strice conjunctus, et labeat in gubernum filial condam domini Balsae*”. *Po aty*, 374.

⁴⁴ Giuseppe Gelcich, *La Zedda e La Dinastia dei Balšidi*. Studî storici dokumentati del Prof. Giuseppe Gelcich (Spalato: Tipografia Sociale Spalatina (G. Laghi), 1899), pa nr. faqeje. Tavola geneologica II.

⁴⁵ Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, 362-363.

⁴⁶ Millutinoviq, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, 54.

kishte pasur ndoshta me gruan e dytë, që mund të ketë qenë e bija e Kojë Zakarisë, martesë me të cilën datohet në nëntor të vitit 1412.⁴⁷ Ajo ose e kishte braktisur, ose kishte vdekur para Balshës.⁴⁸ Megjithatë Gelcich-i, është i mendimit që edhe këto dy bija ishin të gruas së parë.⁴⁹ Kurse i biri i vetëm, që i kishte lindur vite më parë dhe për lindjen e të cilit kishte bërë 8 ditë festime, i kishte vdekur në shtator të vitit 1415.⁵⁰ Balsha në prag të vdekjes ia la tokat e veta në formë simbolike dajës së tij, Stefan Lazareviqit.⁵¹

Më tej, në lidhje me të ëmën e Balshës III, Helena Balsha (1365-1443), mund të thuhet se ajo ishte e bija e despotit serb Lazar Hrebljanoviq (Lazar Hrebeljanović). Ajo ishte një grua energjike nga natyra dhe sa kishte qenë gjallë i shoqi, Gjergj II Strazimir Balsha, nuk ishte pajtuar kollaj me politikën e tij të vogël dhe me masat që merrnin venedikasit për të mbrojtur tregtinë dhe pushtetin e tyre në Zetë dhe në Arbërinë Veriore.⁵² Pas vdekjes së Gjergjit ajo u martua në vitin 1411 me Sandal Hraniqin (Sandalj Hranić), dukën e Bosnjës, që dikur e kishte pasur armik. Hraniqi vdiq në vitin 1435. Pas vdekjes së tij, Helena u kthye në Zetë dhe u mbyll në manastirin Beshka Gorica (Beška Gorica) që ndodhet në veri të Liqenit të Shkodrës, për ndërtimin e të cilit kishte kontribuar ajo vetë dhe qëndroi aty derisa vdiq në fillim të vitit 1443, dhe aty u varros,⁵³ brenda kishës së Shën Gjergjit.

Ajo pra erdhi dhe vdiq në Zetë, në afërsi të Vir Pazarit, jo shumë larg Shkodrës, aty ku kishte pasur kulmin dhe perëndimin e pushtetit të saj. Vitet e fundit që i kishin mbetur ajo i kaloi duke studiuar tekstet religjioze dhe la emër në historinë e letërsisë së sllavëve të Jugut, për shkak të korrespondencës së saj me Nikonin e Jerusalemit.⁵⁴ Me vdekjen e këtyre dy figurave shënohet edhe fundi i principatës së Zetës.

⁴⁷ Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, 362-363; shih edhe: Gelcich, *La Zedda e La Dinastia dei Balšidi*, pa nr. faqeje. Tavola geneologica II.

⁴⁸ Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, 363.

⁴⁹ *Po aty*, 364.

⁵⁰ *Po aty*, 362.

⁵¹ Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*, 85.

⁵² Millutinoviq, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, 47.

⁵³ Svetlana Tomin, “Jelena Balšić”, URL:

<http://knjizenstvo.etf.bg.ac.rs/en/authors/jelena-balsic> (shikuar më 13.01.2014)

⁵⁴ Letrat e saj janë të ruajtura në të ashtuquajturin *Gorica Manuscript* (*Gorički zbornik*) e viteve 1441/42, një korpus dorëshkrimesh, që përveç korrespondencës së saj përmban edhe një koleksion tekstesh të mbledhura me sa duket nga vetë Helena. Ky

Përpjekjet ose lufta e parë e Balshës III për marrjen e Shkodrës, 1404-1405

Le të kthehemi tani sërish në vazhdimësinë e ngjarjeve rreth përpjekjeve të Balshës III për marrjen e Shkodrës. Balsha III qysh në fillim nuk diti që ta ruante miqësinë me Venedikun dhe ta shfrytëzonte atë në dobinë e tij, dhe kjo sipas Gelcich-it ishte një gabim i rëndë.⁵⁵ Ai mendonte vazhdimisht që ta shtinte Shkodrën dhe krahinat përreth nën dominimin e tij.⁵⁶ Ai bëri aleancë edhe me Niketë Topinë, i cili, me sa duket, kishte të njëjtat interesa si vetë Balsha III.⁵⁷ Si rrjedhojë pati kryengritje dhe këtu mund të përmendim atë të vitit 1404-1405. Megjithatë Balsha III, i cili shtyhej edhe nga e ëma, Helena, i hyri kësaj lufte i papërgatitur. Kështu, që në fillim pësoi një goditje pasi, ndër të tjera, siç njoftonte kontkapiteni i Shkodrës, Fantinos Marcelo, në Shkodër në fund të vitit 1404, venedikasit zbuluan një grup komplotist qytetarësh që në dokument thuhet se kishin bërë një marrëveshje tradhtie (*tractato prodicionis*).⁵⁸ Pra, përveç dëshirës së Balshës III për të shtënë nën sundimin e tij Shkodrën, trazirat që u shkaktuan kishin edhe shkaqe të tjera që lidheshin me disa të drejta të feudalëve pronarë, të cilat nuk u morën parasysh. Këtu mund të përmendim, së pari, mosmarrjen parasysh të kontributit të tyre për mbrojtjen e qytetit me forcat e tyre ushtarake. Mbrojtja e Shkodrës u kaloi forcave venedikase, më tej edhe rolin që kishin pasur për mbledhjen e rentës së kryezotit, të cilën nuk mund ta mblidhnin më feudalët në fjalë, por njerëz të administrimit venedikas.⁵⁹ Këtyre u shtoheshin edhe disa cenime të drejtash që bashkia e qytetit të Shkodrës i kishte pasur gjatë periudhës së Gjergj II Strazimir Balshës dhe

korpus ka rëndësi për dy arsye: *së pari*, dëshmon aftësitë letrare të Helenës, dhe *së dyti*, është korpusi më i rëndësishëm letrar i Zetës mesjetare, i cili dëshmon prezencën dhe forcën e spiritualitetit bizantin në atë krahinë. *Po aty*.

⁵⁵ Gelcich, *La Zedda e La Dinastia dei Balšidi*, 231.

⁵⁶ Konstantin Jireček, “Skutari und sein Gebiet im Mittelalter”, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. (München/Leipzig: Duncker und Humblot, 1916), 112.

⁵⁷ Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 162.

⁵⁸ *AAlb*. II, nr. 758.

⁵⁹ Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 163.

që i ishin konfirmuar edhe në marrëveshjen e vitit 1396.⁶⁰ Ndër të tjera, mund të përmendim këtu edhe dajlanet e peshkimit në Bunë që u përkisnin bashkisë dhe kishave, të cilat u konfiskuan. Përveç kësaj, administrata venedikase shtiu në dorë edhe doganat e saragave, të verës së jashtme dhe të thertoresh dhe prona të tilla nuk u sekuestruan vetëm në Shkodër, por edhe në Drisht e në Lezhë.⁶¹

Pastaj krahas këtyre problemeve, në fund të vitit 1402, administrata venedikase hartoi edhe kadastrën e parë të Shkodrës që u ndërmor nga rektori venedikas Donat da Porto, gjë që solli zgjerimin e pronave gjatë viteve 1403-1404, të cilat i takonin bashkisë së saj të re në krahinën e Nënshkodrës dhe kalimin e disa pronësive tek ushtarakë venedikas, si për shembull fshati Gleros (diku në afërsi të Beltojës) që i takonte bashkësisë qytetare, iu dha në pronie një ushtaraku venedikas të quajtur Johan (Zuan) Anglezit dhe trashëgimtarëve të tij.⁶² Administrata venedikase veproi kështu edhe me prona të tjera, duke rritur ndjeshëm pronat e bashkisë venedikase të Shkodrës pas zbulimit të komplotit, për t'ua dhënë më vonë me sa duket edhe të besueshmëve (*boni homines*),⁶³ por njëkohësisht duke shkaktuar edhe zemërimin dhe kryengritjen e një numri qytetarësh shkodranë, ndër të cilët përmenden “tradhtari” Moisi Vita me vëllezër,⁶⁴ Pjetër Bojçini,⁶⁵ Pjetër Moza,⁶⁶ Lazër Kabroshi,⁶⁷ Andrea Suinçi⁶⁸ e këpucari Dabesej që i kishin pronat e tyre në vendin e quajtur *te Frashnat*.⁶⁹ Shumë prej këtyre proniarëve feudalë përmenden tashmë 10 vjet më vonë në kadastrën e Shkodrës, 1416-1417 si të

⁶⁰ Po aty.

⁶¹ AAlb. II, nr. 756.

⁶² *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Tiranë: 1977), 80a; Më vonë Zuan Anglezi shfaqet edhe si kreu i Barbullushit. *Po aty*, 116a.

⁶³ “1405, 10. ianuarii. Venetiis. “Cum per ea, que sentiuntur de prosperitate dispoti Sclavonie, consideratis etiam hiis, que scripsit nobis vir nobilis ser Fantinus Marcello comes et capitaneus Scutari de tractatu prodicionis detecto”, loco Scutari periculum imminet statuitur, stipendio conducantur 12 boni homines, “qui sint cum probo viro Antonio Sclavo comestabile nostro equestre in Scutaro ” AAlb II, 758.

⁶⁴ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve*, 20b; 158b.

⁶⁵ *Po aty*, 18b, 158b.

⁶⁶ *Po aty*, 158b.

⁶⁷ *Po aty*.

⁶⁸ *Po aty*.

⁶⁹ Shih edhe: Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 166.

shpronësuar dhe të cilësuar si tradhtarë, dhe pronat e tyre u kishin kaluar të tjerëve.

Me konfiskimin e pasurive të tyre, u rrit në mënyrë të ndjeshme fondi i tokave të bashkisë venedikase në qytetin e Shkodrës. Kjo politikë e Sinjorisë që u shoqërua edhe me masa të rrepta, sidomos në qytetin e Drishtit, krijoi një situatë revolucionare në krahinën e Shkodrës në prag të luftës kundërvenedikase të vitit 1404-1405.

Të shantazhuar nga Venediku dhe të kërcënuar nga Sandal Hraniqi i Bosnjës, Balsha III e Helena iu drejtuan turqve për ndihmë dhe Balsha bëhet vasal i tyre. Kështu me forcat e sanxhakbeut të Shkupit dhe të vasalëve të tij që ishin Vuk Brankoviqi dhe despoti serb, Balsha III u forcua shumë dhe me këto forca iu vërsul Shkodrës, Drishtit dhe Ulqinit, duke zënë robër dhe duke plaçkitur bagëti.⁷⁰ Venedikasit nga ana e tyre morën masa dhe dërguan në krahinën e Shkodrës, 100 lança.⁷¹ Një dokument i rëndësishëm që na tregon për ndonjë masë të marrë dhe personat që ishin ngarkuar me këtë punë është ai i datës 12 janar 1405, ku përmenden Andrea Sklavo, Anton Spani dhe Donato da Porto,⁷² i cili më parë kishte qenë edhe hartuesi i kadastrës së parë të Shkodrës në vitet 1402-1403.⁷³

Duke pasur parasysh këto trazira që erdhën si rrjedhojë e këtyre veprimeve, venedikasit rritën disa herë numrin e ushtarëve me pagë në posedimet e tyre në Shqipëri, sidomos në Shkodër, Drisht dhe Lezhë. Nga një dokument i datës 13 nëntor 1404, dëshmohet se në krahinat e sipërthëna u dërguan 30 balistjerë, ndër këta 6 ishin caktuar për Drishtin, 6 për Lezhën dhe 18 të tjerët për Shkodrën.⁷⁴ Përveç kësaj u riparuan edhe kështjellat përreth, sidomos ajo e Drishtit⁷⁵ dhe e Lezhës.⁷⁶

⁷⁰ Millutinoviç, "Drishti nën sundimin e Venedikut", 48.

⁷¹ *Istoria Crne Gore*, Knjiga druga. Od Kraja XII do Kraja XV vijeka, Tom Drugi: Crna Gora i doba oblasnih gospodara. (Titograd: Redakcija za istoriju Crne Gore 1970), 90.

⁷² *Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV*, vëll. I (1400-1405), përgatitur nga Injac Zamputi dhe Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda (Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1987), dok. nr. 485.

⁷³ Bogdani, "Lufta kundër Venedikut", 1983, 169.

⁷⁴ *AAlb. II*, nr. 753; *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Parstis Primae: Saeculum XIV complectentis. Tomus Tertius: Ab anno MCCCXCVI ad annum MCDVI. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi del' Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma/ Albanien Institut, Universität München/

Pastaj në një dokument tjetër të mëvonshëm (të datës 10 janar 1405) rritet numri i kalorësve me pagë, të atyre që cilësoheshin si njerëz të besueshëm (*boni homines*) edhe me dymbëdhjetë të tjerë, që do të ishin nën komandën e komestabelit Anton Sklavi (*Antonio Sclavo*).⁷⁷ Përveç kësaj, një meritë të veçantë në anën e venedikasve mban edhe kapiteni i flotës së detit Adriatik, Marin Karavelo, i cili ia doli që t'i nxiste kundërshtarët e Balshajve kundër Balshës III dhe s'ëmës së tij dhe të vendoste më në fund edhe pushtetin venedikas në Shkodër e rrethina.⁷⁸

Edhe pse në Shkodër grupi komplotist u zbulua, kryengritja mori përmasa të gjera dhe në të u përfshinë edhe zona të tëra të Nënshkodrës me pronarët e fshatrave Balldre, Kakarriq, Sakol, Zamoranj, Ndreshkies, Muzhan, Gramsh, Dajç, Beltojë, ndër të cilët mund të përmendim Gjergj Dukagjinin, me 40 kalorës e 100 këmbësorë; Stefan Ronjën; Andrea Sllavin; rebelin Nikë Bogojë;⁷⁹ Pjetër Konten, ish-kreun e fshatit Beltojë (Belomi) që më vonë cilësohet si tradhtar dhe të drejtat mbi fshatin e tij më pas i kaluan Andrea Spanit e të birit Stefan Spani,⁸⁰ të cilët njiheshin si besnikë të venedikasve etj.

Kur kontkapiteni venedikas i Shkodrës u bëri thirrje pronarëve feudalë vendës për ndihmë kundër kësaj kryengritjeje, shumë prej tyre nuk iu përgjigjën thirrjes së tij, por përkundrazi, u bënë vetë pjesë e kryengritjes. Ndër këta mund të përmendim Gjon Jonimën, Aleks Beganin, Stefan e Gjon Miliotinin, më tej edhe Nikollë Kilitin dhe Andrea Svinçin.⁸¹ Thirrjes së venedikasve iu përgjigjën vetëm disa pronarë të paktë, si për shembull, Jon Prekali, i cili banonte në Shkodër dhe kishte si pronie fshatin Prekal; Dhimitër Sigjeqi nga fshati Sigjeq,⁸² dhe Andrea Spani, i cili gjatë kësaj periudhe ndodhej në Venedik dhe

Südost Institut, München / Institut für Geschichte und Kultur des Nahen Orients, sowie für Turkologie, Universität München. München: Rudolph Trofenik 1968., nr. 1092 (Në vijim cituar si: AAV III, nr.).

⁷⁵ *Dokumente për historinë e Shqipërisë*, I, dok. nr. 472.

⁷⁶ *AAlb.* II, nr. 754; AAV III, nr. 1094.

⁷⁷ *AAlb.* II, nr. 758.

⁷⁸ Millutinoviç, "Drishti nën sundimin e Venedikut", 48.

⁷⁹ *Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*, përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (Tiranë: 1977), 97a (më tej cituar: Regjistri).

⁸⁰ Regjistri, 79b, shih edhe: Bogdani, "Lufta kundër Venedikut", 1983, 166.

⁸¹ Regjistri, 23b, 129a; shih edhe: Bogdani, "Lufta kundër Venedikut", 1983, 166.

⁸² Bogdani, "Lufta kundër Venedikut", 1983, 169. (ASV. Del Mistre Sen. L/ 63v)

erdhi bashkë me ta e luftoi në anën e tyre. Jon Prekali hyri në kështjellën e Shkodrës dhe luftoi përkrah forcave venedikase, kurse Dhimitër Sigjeqi u kishte dhënë atyre një ndihmë të madhe.⁸³ Për sa u përket atyre proniarëve, të cilët gjatë luftës ditën të mbanin një qëndrim jokomprometues në sytë e venedikasve, mund të përmendim këtu Vuk Gubiçiqin, Bitrin e Zi, Junk Tuzin dhe Radosllav Romestinën, të cilët në vitin 1403 kishin përfitur dhurata nga Donato da Porto, i cili një vit më vonë, në kohën kur shpërtheu kryengritja bëhet kont venedikas i Shkodrës.⁸⁴

Kryengritja u përkrah edhe nga kleri katolik i Shkodrës dhe i Drishtit. Këtu mund të përmendim ipeshkvin e Shkodrës dom Progonin që më vonë në regjistrin e kadastrës përmendet si tradhtar dhe arqidiakonin e Drishtit, Palë Ungrin, i cili madje mori pjesë në luftë,⁸⁵ por që mbas shuarjes së kryengritjes zihet rob dhe internohet në Venedik, ku jetoi më pas në gjendje të mjerueshme.⁸⁶ Balsha III arriti ta shtinte në dorë Shkodrën me rrethina⁸⁷ dhe këtë e mësojmë nga një dokument raguzan i datës 8 shkurt 1405, në të cilin thuhet se “zoti Balshë, i biri i të ndjerit Gjergj Strazimiri Zot i Zentës dhe ushtarët e territorit të tij kanë marrë sërish qytetin e Shkodrës”.⁸⁸ Megjithatë, kështjella e Shkodrës ishte akoma në duart e venedikasve.⁸⁹ Për marrjen e kështjellës, Balsha III ndërmoi një rrethim dhe sulme të shpeshta që zgjatën rreth gjashtë muaj dhe u bënte thirrje shqiptarëve që ndodheshin brenda mureve që të dilnin, se nuk do t’i trazonte por do t’i linte të kalonin lirisht.⁹⁰ Për sa u përket pronave dhe pasurive të venedikasve në qytetin e Shkodrës, Balsha III u soll rreptësisht ndaj tyre, duke ua sekuestruar mallrat e duke sulmuar shtëpitë e tyre.⁹¹

Si rrjedhim, pushtimi i krahinës së Shkodrës bëri që anijet venedikase tregtare të tregonin kujdes të madh ose të mos hynin në

⁸³ Po aty. (ASV. Del Mistre Sen. XLVIII/ 138, 143,146)

⁸⁴ ASV, Senato Misti 46, 137, shih tek: Rulers of Venice (shikuar më 20.04.2023):

URL: <https://rulersofvenice.org/search>

⁸⁵ Lajçi, *Shkodra në shekullin XV*, 74.

⁸⁶ Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 168.

⁸⁷ *Dokumente për historinë e Shqipërisë*, I, nr. 492.

⁸⁸ *Po aty*, nr. 491.

⁸⁹ Orbini, *Il Regno degli Slavi*, 294; shih edhe *Dokumente për historinë e Shqipërisë*, I, nr. 492.

⁹⁰ Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 168.

⁹¹ Po aty.

Shkodër, madje të mos shkonin as te porti lumor i Shën Shirqit në breg të Bunës, nga frika se mund të plaçkiteshin dhe të keqtrajtoheshin nga Balsha III dhe njerëzit e tij.⁹²

Venediku bëri përpjekje të vazhdueshme për ta zhbllokuar situatën. Gjatë kësaj kohe venedikasit ishin të zënë edhe me një luftë tjetër ndaj Padovës, dhe për ta shuar këtë kryengritje në Shkodër dhe në krahinat përreth iu kërkua ndihmë e mbështetje ushtarake edhe Sandalj Hraniqit, kurse lezhjanët që ishin treguar besnikë ndaj Venedikut u shpërblyen.⁹³ Venedikasit kishin shpresa se Sandalj Hraniq do t'iu vinte në ndihmë atyre, ngaqë kishte pasur konflikte me derën e Balshajve sidomos gjatë kohës së Gjergj II Strazimirit dhe të birit Balsha III, sepse këta e kishin bezdisur sa e sa herë Kotorrin, që kishte qenë në zotërimin e Bosnjës (nën Mbretin Tvrtko I) që nga viti 1385, dhe kishin dashur ta pushtonin atë.⁹⁴

Në Venedik, më 7 maj të vitit 1405, të dërguarve Nicolaus Fuscus dhe Heustachius Cauchus iu dhanë udhëzimet që të shkonin te zoti Sandalj për t'i shprehur hirin dhe konsideratën e tyre më të lartë.⁹⁵ Më tej, ata duhej t'i shprehnin atij dëshirën e Venedikut për ripushtimin e Shkodrës dhe të Drishtit dhe t'i luteshin, nëse dëshironte, t'u jepte atyre ndihmë me qëllim që të rifitonin vendet e tyre të sipërpërmendura.⁹⁶

Në këtë letër me udhëzime, ata u shkruanin dy të dërguarve Fuskus dhe Kaukus, që duhej t'i shprehnin Sandaljit, se venedikasit ishin të kënaqur dhe ju pëlqente që t'i premtonin se do t'i jepnin atij 1 000 dukate ari për çdo vit për festën e Krishtlindjeve, ose 3 000 dukate menjëherë, nëse ata i pushtonin këto dy qytete me mbështetjen dhe kontributin e tij.⁹⁷ Porse, lidhja e një aleance me Sandaljin dështoi, sepse

⁹² AAlb. II, nr. 761.

⁹³ Giuseppe (Zef) Valentini, *Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë 1060-1560* (Pa vend botimi: Plejad, 2010), 216-217.

⁹⁴ Jovan Radonić, "Der Grossvojvode von Bosnien Sandaljs Hranic-Kosač", në: *Archiv für Slavische Philologie*. Unter Mitwirkung von A. Brückner (Berlin), J. Gebauer (Prag), C. K. Jireček (Wien), A. Leskien (Leipzig), W. Nehring (Breslau), St. Novaković (Belgrad), A. Wesselosky (St. Petersburg). *Herausgegeben* von V. Jagić. Neunzehnter Band (Berlin: Weidmansche Buchhandlung, 1897), 402.

⁹⁵ AAlb. II, nr. 766; AAV III, nr. 1121; shih edhe: Radonić, "Der Grossvojvode von Bosnien", 403.

⁹⁶ AAlb. II, nr. 766; AAV III, nr. 1121.

⁹⁷ AAV III, nr. 1121; AAlb. II, nr. 766; shih edhe: Radonić, "Der Grossvojvode von Bosnien", 403.

ai kishte pretendime të mëdha. Të dërguarit me provizionin prej 1 000 deri në 3 000 dukate, si dhe nga bisedimet e bëra me të nuk arritën gjë.⁹⁸

Dokumentet nuk na sqarojnë më tej në lidhje me dështimin e kësaj aleance, por, me sa duket, venedikasit vunë re një lloj pangopësie të Sandaljit, sepse në shtator të vitit 1405, pasi venedikasit kishin pushtuar Shkodrën, Drishtin, Ulqinin, Tivarin dhe Budvën, erdhën të dërguarit e Mbretit boshnjak Tvrtko I dhe u kërkuan venedikasve Tivarin, Ulqinin dhe Budvën për Sandaljin,⁹⁹ kurse në maj të vitit 1406, në Venedik u paraqitën përfaqësuesit e Mbretit Vladislaus të Hungarisë dhe i kërkuan Sinjorisë Tivarin dhe Budvën po për Sandaljin, i cili kishte filluar ta quante veten sundimtar në disa anë të Arbërisë “*dominus in partibus Albanie*”.¹⁰⁰

Venedikasit u munduan edhe në forma të tjera me anë të parave që të kapnin të gjallë Balshën, duke ofruar në fillim 500 dukate dhe të mira të tjera më vonë. Kur nuk doli ndonjë që ta bënte këtë punë, ata e rritën shumën deri në 2 000 dukate për atë që do t’u sillte atyre në dorë Balshën e gjallë.¹⁰¹ Në lidhje me kapjen gjallë të Balshës, Senati venedikas u dha udhëzim edhe rektorëve të krahinave në afërsi që, për t’ia arritur këtij qëllimi, kishin në dispozicion shumën e sipërthënë (prej 2 000 dukatesh).¹⁰² Përveç kësaj, ata për të shtënë në dorë Shkodrën e Drishtin menduan që të provonin të rinovonin marrëveshjet e dikurshme me Kojë Zakarinë dhe Dhimitër Jonimën,¹⁰³ të cilat ata i kishin pasur para disa vjetëve (1400), duke u paguar atyre provizionet në shumën e dikurshme prej 500 dukatesh në vit.¹⁰⁴

Nga ana tjetër, Balsha III dhe e ëma, Helena, u përpoqën të kërkonin ndihmë edhe te raguzanët, por morën këtë përgjigje si më poshtë: “Komuna e Raguzës i shkruan zonjës Helenë dhe Zotit Balshë se i kanë marrë letrat e dërguara nëpërmjet shërbëtorit Dhimitër dhe për ato

⁹⁸ ASV. Del Secr. Sen. II/147rv, cituar sipas: Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 169.

⁹⁹ Shih për këtë edhe dokumentin: *AAIb.* II, nr. 777.

¹⁰⁰ Radonić, “Der Grossvojvode von Bosnien”, 403.

¹⁰¹ At Giuseppe (Zef) Valentini, *Statuti personal në Shqipëri në epokën e Skënderbeut (Shënime nga Arkivat e Republikës Venete)*, botimi i parë, redaktuar nga Ndrichim Kulla dhe Ksenofon Krisafi, përkthyer nga Dritan Thomollari (Tiranë: Plejad, 2007), 166, ref. 88.

¹⁰² *AAIb.* II, nr. 788; *AAV* III, nr. 1160.

¹⁰³ *AAIb.* II, nr. 788; *AAV* III, nr. 1160.

¹⁰⁴ *AAIb.* II, nr. 659; *AAV* III, nr. 846.

që lutet zotërimi juaj si gjëra të rëndësishme për ju, të mos na lutet më për to, se siç e di zotërimi juaj, ne jemi miqtë tuaj por edhe miqtë e zotërimit venedikas.”¹⁰⁵ Nga dokumenti nuk mësojmë se çfarë është kërkuar nga ana e Balshës III dhe nënës së tij, por pa dyshim që duhet të ketë qenë ndonjë kërkesë për ndihmë në luftën kundër venedikasve, sidomos armë.

Venedikasit tentuan më pas t'i shtinin në dorë vendet e sipërpërmendura nëpërmjet parave duke dërguar ambasadorë te Helena dhe i biri i saj, Balsha III, duke i premtuar asaj shumë nga 1 000 deri në 2 000 dukate në vit, po ashtu edhe titullin “*Bijë të Sinjorisë*” si dhe për baronët e saj, nëse ata nuk do të praninin deri në 500 dukate provizion. Por, ky propozim nuk u pranua nga Senati.¹⁰⁶

Pati edhe mendime të tilla, me anë të të cilave sugjerohej që Sinjoria të njihte pushtetin e Balshajve në krahinën e Shkodrës, por me kusht që të ruhej i pacenuar interesi ekonomik dhe monopolet e tregtarëve venedikas, që ata kishin sidomos me tregtinë e drithit, si dhe kthimin e mallrave të sekuestruara dhe kthimin e shumave që ishin shpenzuar në këtë krahinë deri në atë kohë.¹⁰⁷

Duke parë se nuk mund të arrinin në ndonjë marrëveshje me anë të bisedimeve me Balshën III, venedikasit vendosën që të mbronin interesat e tyre me forcën maksimale të armëve dhe bënë një plan të hollësishëm sulmi, në të cilin parashikohej, jo vetëm çarja e rrethimit të Shkodrës dhe mbrojtja e krahinës së Lezhës, por edhe sulme të ndryshme mbi territoret e tjera të Balshajve si në Ulqin, Tivar dhe Budva, me qëllim që këtyre krahinave t'u shkaktoheshin sa më shumë dëme, dhe mundësisht edhe t'i pushtonin.¹⁰⁸ Për pushtimin e Ulqinit venedikasit u ndihmuan nga ipeshkvi katolik i qytetit, Jakob Markoci,¹⁰⁹ qytetari i pasur Edom de Pice,¹¹⁰ dhe Jakë e Mark Kamaca, pjesëtarë të familjes së pasur

¹⁰⁵ “1405, 11. ianuarii. Ragusii: “*Commune Ragusii dominae Helenae et domino Balsae se litteras eorum per servitorem Dimitrium missas recepisce scribit. „Quae ibi dominatio vestra petit tanquam vobis necessaria, ne petat a nobis, oramus, nam dominatio vestra scire nos servitores et amicos esse vestros ac etiam amicos esse domini Veneti.”* *Lettere e com. di Levante 1399-1423.*” AAlb. II, nr. 759.

¹⁰⁶ *Dokumente për historinë e Shqipërisë*, I, nr. 524.

¹⁰⁷ Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 169.

¹⁰⁸ Po aty, 170 (ASV. Del Mistè Sen. XLVII/ 2(4)v).

¹⁰⁹ Po aty, 171 (ASV. Del Mistè Sen. LI/ 147 (150)rv).

¹¹⁰ Po aty, 171 (ASV. Grazie R°20 (18/95 (112)).

Kamaca,¹¹¹ ndërsa ushtaraku Deskë Kresha prej Shkodre, i cili shërbente në kështjellën e Ulqinit u krijoi kushte venedikasve për pushtimin e kësaj kështjelle,¹¹² dhe një pjesë e mirë e trupave të Balshës III kaloi me Venedikun. Ulqini u mor nga venedikasit më 24 korrik 1405.¹¹³

Para se të shpërthente kryengritja, Balshës III i ishin afruar disa bujarë, emrat e të cilëve ishin Radiç Humoi fisnik shkodran dhe proniar i Balecit, që më parë konsiderohej si besnik i venedikasve;¹¹⁴ Niko Bogoje, Pjetër Konti, Nikolla Lumbardhini, Andrea Sklavo, Nikolla Sigeci, Pjetër dhe Stefan Spani, të cilët kur panë se Balsha nuk i kishte punët fare mirë, u penduan dhe iu nënshtruan edhe një herë venedikasve, të cilët disa prej tyre i shpërblyen me prona rreth Shkodrës.¹¹⁵

Përveç frikës së humbjes, një pjesë e kryengritësve u bënë pre edhe të një demagogjie premtimesh nga ana e venedikasve, gjë që çoi në përçarjen e forcave kundër Venedikut e si rrjedhojë pati disa fisnikë të cilët u lidhën me marrëveshje të fshehta me komandantin venedikas të Gjirit, Marin Karavelon. Ndër këta mund të përmenden kreu i Pamaliotëve, Dukaleti, i cili ishte një fisnik me peshë në oborrin e Balshajve; krerët e Popratit Aleksii dhe Pjetri, si dhe Pjetër Shestani, kreu i Malcisë së Tivarit.¹¹⁶

Venedikasit ia morën Balshës III qytetin e Shkodrës në maj të vitit 1405; më pas ata pushtuan edhe qytetet e Tivarit dhe të Budvës në muajt qershor-korrik të vitit 1405,¹¹⁷ dhe më vonë u mor edhe qyteti i Drishtit.

Pasi kryengritja u shua, rektori i Shkodrës, i cili kishte luajtur një rol të rëndësishëm u mbulua me lavdi.¹¹⁸ Në lidhje me këto ngjarje kemi gjetur edhe një dokument që i përket *Kodeksit Morosini* dhe bën fjalë për gruan e Gjergj II Strazimir Balshës, që në dokument përmendet me emrin Magdalena (dhe jo Helena), e cila u detyrua të largohet nga Shkodra dhe gjeti strehim në Drisht, i cili ra në duart e venedikasve më vonë. Përmbajtja e këtij dokumenti vijon si më poshtë:

¹¹¹ Po aty, 171 (ASV. Grazie R°20 (18/95 (112)).

¹¹² Po aty, 170 (ASV. Del Miste Sen. XLVII/ (144)/ 146 (148)).

¹¹³ Gelcich, *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*, 265.

¹¹⁴ “Raducius Homoy, untis ex nobilibus civitatis nostre Scutari, exponens, quod consideratis fidelibus operibus et bono portamento eius versus honores et exaltationem nostri dominii.” AAlb. II, nr. 752.s

¹¹⁵ Millutinoviç, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, 48.

¹¹⁶ Bogdani, “Lufta kundër Venedikut”, 1983, 170.

¹¹⁷ Po aty, 171.

¹¹⁸ Valentini, *Kontribute në kronologjinë e historisë*, 216.

“Gjatë vitit 1405 në Venedik. Më 16 qershor të këtij viti ne dëgjuam përmes lajmeve të reja që vinin nga Kandia, që kapiteni ynë fisnik i galeave të Gjirit kishte arritur në Shkodër me 5 gala dhe ata të qytetit u përgjigjën me zjarr të rëndë topash, kështu që kapiteni ynë u përgjigj po ashtu këtij zjarri dhe e mori qytetin me forcë, pasi ky qytet ishte rebeluar kundër Sinjorisë kohë më parë. Si përfundim, zonja Magdalena [*Helena – E.M.*] e veja e zotit Gjergj Strazimiri, qe e detyruar të arratisesh nga qyteti bashkë me të birin e saj, duke u tërhequr për t’u mbrojtur në qytetin e Drishtit. Dhe kështu ne dëgjuam që qyteti i Shkodrës bashkë me fortesë u kthye në mënyrë paqësore nën bindjen e Sinjorisë dogjale, dhe kjo ndodhi më 3 qershor, gjë që u mbajt nga të gjithë si lajm i mirë”.¹¹⁹

Ajo pra, detyrohet të lërë edhe Drishtin, dhe me sa duket iku me të birin në Venedik dhe arrin aty në gusht. Kështu kështjella mbeti në duart e doxhës së Venedikut. Mbi vendqëndrimin se ku do të rrinte nuk dihej shumë. Mendohej se ajo ndoshta mund të kishte shkuar diku në krahinat e Shkodrës.¹²⁰

Vendësve (duke përfshirë këtu shkodranët në veçanti, por edhe drishtjanët), të cilëve u ishin shteruar të ardhurat nga lufta, iu ngarkua edhe e gjithë barra e luftës (d.m.th. humbjet materiale) kundër Balshajve

¹¹⁹ 1405.06.03-16 Morosini Codex (§063.0188): “*Chorando M IIII cento V dito in Venexia. A di XVI de zugno del dito milieximo avesemo per novela vegnuda per la via de Candia, chomo el nostro nobel homo chapetanio de le galie del Cholfo se apre- // a xentà a Schutari b chon V galie, e per quelì de la tera fo respoxo de molte bonbarde, de che i nostri se mese a far resistencia e per forza ave la tera, la qual per molto tenpo per avanti de aveva revelado a la Dogal Signoria. De che a le per fin chonstreta la dona madona Madalena muier che fo de misier Ziorzi Strazimier insenbre chom meso so fio schanpà de la tera redugandose intro el chastelo de Trievasto per so’ segurtade. E chusi avesemo la tera chom la forteza libera tornada tuta a la hubidiencia de Schutari a la Dogal Signoria a di tre de quel prexente mexe de zugno, la qual per tuti fo tegnuda bona novela.*” Edmond Malaj, *Drishti. Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar* (Tiranë: ASA, Instituti i Historisë, 2015), 397.

¹²⁰ 1405.08.19 Morosini Codex (§063.0223): “*Avesemo a di XVIII d’avosto de M CCCC V per nuove vegnude, la dona de misier Ziorzi Strazimier se parti chon meso el fio so del chastelo de Andrievasto, per tal muodo el chastelo sia romaxo a la Dogal Signoria. Ma là ho quela dona sia andata avemo non sia stado dito anchora, ma credese la vignerà a star a Venexia, hover che la sia andata in verso le parte de Schutari, ma per avanti se vignerà in noticia de quela.*” Malaj, *Drishti. Historia dhe fizionomia*, 397.

dhe përveç kësaj ishin të detyruar të kujdeseshin edhe për lundrueshmërinë e Bunës nga Liqeni i Shkodrës deri në detin Adriatik.¹²¹ Gjatë kësaj kohe u bënë edhe riparime të kështjellave në Shkodër dhe në Drisht.¹²²

Edhe pse qytetet tashmë ishin sërish në duart e venedikasve, akoma nuk kishin pushuar trazirat dhe mundësia e daljes nga kjo situatë e vështirë shihej vetëm në marrëveshjen e një paqeje midis dy palëve. Negociatat për këtë paqe filluan, më 6.6.1408 me iniciativën e Balshës III, zgjatën rreth dy vjet dhe përfunduan më 7.6.1410.¹²³

Në këto negociata u angazhuan shumë njerëz të shquar nga Zeta, nga Shqipëria dhe nga Venediku. Disa prej tyre ishin Mërksha Zharkoviçi, Mara Brankoviçi*, Nikitë Topia, Nikola Zaulo, Rajko Moneta, Tadeo de Krispis, Marino Karoli, despoti Stefan Lazareviçi, më tej venedikasit Ruberto Morexini, Jacomo de Riua, Piero Arimondo (bajl dhe kapiten i Durrësit), etj.¹²⁴ Se për çfarë bëhej fjalë konkretisht në këto negociata, një rast të tyre na e pasqyrojnë dy dokumente të datave 6 dhe 7 qershor 1408. Aty venecianët kërkonin që Balsha III dhe e ëma, Helena, t'u linin atyre ato vende që ua kishte lënë venedikasve, Gjergj Strazimiri dhe të mos krijonin probleme për to. Si shpërblim atyre do t'u jepeshin 1 500 dukate ari, në dy këste, njërin për festën e Krishtlindjeve, kurse

¹²¹ Valentini, *Kontribute në kronologjinë e historisë*, 49.

¹²² *Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV*. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Pars Secunda: Saeculi XV Praescanderbeganam Periodum complectentis. Tomus Quintus (5): Annos MCDVII ad MCDIX illustrans. Centro internazionale di Studi Albanesi Palermo/ Istituto Universitario Orientale Napoli/ Istituto di Studi Albanesi del' Università di Roma/ Fondazione Giorgio Cini Venezia/ Ponteficio Istituto di Studi Orientali Roma/ Albanien Institut, Universität München/ Südost Institut, München / Institut für Geschichte und Kultur des Nahen Orients, sowie für Turkologie, Universität München. München: Rudolph Trofenik 1968, nr. 1363 (Në vijim cituar si: AAV V, nr.).

¹²³ Millutinoviç, "Drishti nën sundimin e Venedikut", 49.

* **Shënim.** Mara Brankoviçi, e motra e Stefan Lazareviçit, gjyshja e Lazar Brankoviçit (despotit serb pasues në vitet 1456-1458), i cili kishte tri bija: Marijen, Milicën dhe Jerinën. Maria do të bëhej më vonë mbretëresha e fundit e Bosnjës duke u martuar me Stefanin trashëgimtarin e fronit boshnjak, Milica u martua me despotin Leonhard III, nga familja Toko (Toco) në Ksante, kurse ajo që na intereson më tepër, Jerina u martua me Gjon (Gjin) Kastriotin, të birin e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut. Shih: Ruvarac, "Zwei bosnische Königinnen", 381.

¹²⁴ AAV V, nr. 1351, 1352.

tjetrin për festën e Shën Maries në muajin gusht.¹²⁵ Sipas traktatit të dalë nga kjo paqe, venedikasit do të mbanin nën zotërimin e tyre Ulqinin dhe Tivarin, kurse Balsha III do të mbante Budvën, Lushticën dhe kriporet, si dhe zonën e Pastrovicëve. Përveç kësaj, do të përfitonte nga venedikasit 1 500 dukate në emër të provizionit të Shkodrës.¹²⁶

Paqja në fjalë, e firmosur edhe nga Balsha III, u nevojitej venedikasve sepse kështu ata do të mund të rregullonin marrëdhëniet me turqit. Por venedikasit, ndryshe bënë haptas dhe ndryshe vepruan në fshehtësi. Ata gjatë periudhës 1408-1409 nga njëra anë bënë përpjekje për të vendosur paqen, nga ana tjetër, në muajt janar-shkurt të vitit 1409 bënë disa seanca të fshehta, në të cilat u diskutua që të nxisnin Bajazitin, sanxhakbeun e Shkupit, që ta detyronte Balshën të bindej për të bërë paqe, sepse me anë të turkut mund të arrihej shumë.¹²⁷ Venedikasit menduan që në fillim ta pyesnin se sa do të dëshironte për këtë, ose përndryshe, nunci venedikas që do të shkonte te Bajaziti, do t'i ofronte atij 500 deri në 1 000 dukate në vit, që do të merreshin nga hyrjet e fitimet e atyre vendeve për të cilat bëhej fjalë.¹²⁸ Ky vendim u mor në Senatën sekret më datë 9 shkurt 1409.

Balsha III u pajtua me marrëveshjen, por nuk e nënshkroi atë, prandaj pritej që të shkonte në Venedik e ta bënte këtë gjë. Ngaqë ai kishte frikë nuk shkoi dhe atje u nis e ëma e tij, Helena, me qëllim që të zgjidhte çështjen. Gjatë qëndrimit të saj atje, nga muaji gusht deri në dhjetor të vitit 1409, u vendos që palët të mbanin ato posedime që kishin pasur para ardhjes së Helenës aty.¹²⁹ Përveç kësaj, asaj iu kërkua që të premtonte fqinjësi të mirë me tokat që zotëronin venedikasit në Shqipëri, me qëllim që nënshtetasit e këtyre trojeve të jetonin dhe të punonin së bashku në paqe e në qetësi.¹³⁰

Megjithatë, Balsha III së bashku me të ëmën, Helenën, në shenjë të vullnetit të mirë më 9.11.1408 kishin nxjerrë një bulë (*bolla*), me të cilën urdhëroheshin të gjithë shtetasit e tij që të respektonin paqen e vendosur, në mënyrë që ata të lëviznin, të punonin e të merreshin lirshëm me punët

¹²⁵ AAV V, nr. 1351, 1352.

¹²⁶ *Po aty*, nr. 1351, 1352.

¹²⁷ *Po aty*, nr. 1400.

¹²⁸ *Po aty*.

¹²⁹ *Po aty*, nr. 1483; Millutinoviç, "Drishti nën sundimin e Venedikut", 50.

¹³⁰ AAV V, nr. 1483.

e tyre.¹³¹ Më 27 tetor 1409, kemi të dokumentuar edhe një “*litteris patente*”¹³² që ka edhe një armëpushim njëvjeçar, për të cilën Balsha zotohej se nuk do ta thyente dhe gjatë kësaj kohe nuk do të ndërtonte fortifikime të reja dhe nuk do të zgjeronte ato që ishin ekzistente.¹³³

Kjo ishte pra paraqitja e asaj që e quajmë kryengritja e viteve 1404-1405, apo edhe Lufta e Parë e Balshës III për marrjen e qytetit të Shkodrës me rrethina, e cila zgjati pothuajse një vit dhe e mbajti kështjellën e Shkodrës për gjashtë muaj të rrethuar. Kjo kryengritje u shtyp por trazirat vazhduan edhe më vonë, edhe pse u bënë marrëveshjeje paqeje, duke çuar në shpërthimin e një lufte të re të Balshës III kundër venedikasve më 1418, e cila do të jetë objekt studimi në një artikull tjetër.¹³⁴

EDMOND MALAJ

Institute of History/ Akademia e Shkencave e Shqipërisë
edmond.malaj@asa.edu.al

S u m m a r y

THE FIRST ATTEMPTS OF BALŠA III AND HIS MOTHER, HELENA, TO TAKE SHKODRA, AROUND THE BEGINNING OF THE 15TH CENTURY

The article above deals with a short part of the history of medieval Shkodra, which is the passage of this town with surroundings under Venetian rule, realized by George II Strazimir Balsha, and then the efforts made by George himself or his son Balsha III and his mother Helena Balsha, for the restoration of these lands under their rule. These efforts are divided into two culminating points that are: 1. The uprisings against

¹³¹ AAV V, nr. 1383; Njëfarë paqeje ishte arritur edhe me një bulë të Balshës më datë 7. 8. 1408; *po aty*, nr. 1352.

¹³² AAV V, nr. 1485.

¹³³ *Po aty*, nr. 1483; *po aty*, nr. 1486; shih edhe: Millutinoviç, “Drishti nën sundimin e Venedikut”, 50.

¹³⁴ Në lidhje me këtë luftë të re të Balshës III kundër venedikasve, e cila nga disa autorë (Millutinoviç, “Drishti nën sundimin e Venedikut”) përkufizohet edhe si “Lufta e Dytë e Balshës III për marrjen e Shkodrës”, kam shkruar tashmë në artikullin: Edmond Malaj, “Përpjekja e dytë e Balshës III gjatë viteve 1408-1421 për rivendosjen e sundimit të tij në Shkodër e rrethina”, në *Hylli i Dritës*, 1 (2023): 105-130.

the Venetians and the Balsha III War during the years 1404-1405, which in some studies is also known as Balsha III's 1st War for Shkodra and; 2. The events of 1418, during which Balsha III and his mother try again to take Shkodra to the Venetians. These events are also encountered with the designation as the Second War of Balsha III for the acquisition of Shkodra. We will handle in this article only the first period dealing with "the uprisings against the Venetians and the Balsha III War during the years 1404-1405 to take Shkodra and its surroundings.

Bibliografi:

Botime dokumentare:

Acta Albaniae Veneta Saeculorum XIV et XV. Josephi Valentini S. J. Labore reperta et Transcripta Ac Typis Mandata. Tomi (Vol.) 1-25. Palermo/ Napoli/ Roma/ Venezia/ München: Archivio di Stato di Venezia 1967-1972.

Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emilianus de Sufflay. Volumen II (Annos 1344-1406 continens Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen.

Literaturë historiografike:

Bogdani, Pranvera. "Lufta kundër Venedikut për çlirimin e krahinës së Shkodrës dhe të qyteteve të saj në fund të vitit 1404 – mesi i vitit 1405". Në *Studime për Epokën e Skënderbeut*, II. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1989.

Bogdani, Pranvera. "Lufta kundër Venedikut për çlirimin e krahinës së Shkodrës dhe të qyteteve të saj në fund të vitit 1404 – mesi i vitit 1405", në: *Studime historike*, 2, 1983.

Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. II (shek. VIII-XV). Përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pipo. Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1962.

Dalipi, Qerim. *Arbëria midis Republikës së Venedikut dhe Perandorisë Osmane (1355-1443)*. Tetovë: ARS-ZZ, 2012.

Dokumente për historinë e Shqipërisë të shek. XV, vëll. I (1400-1405). Përgatitur nga Injac Zamputi, Luan Malltezi, redaktor përgjegjës Aleks Buda. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1987.

- Gelcich, Giuseppe. *La Zedda e La Dinastia dei Balšidi*. Studî storici dokumentati del Prof. Giuseppe Gelcich. Spalato: Tipografia Sociale Spalatina (G. Laghi), 1899.
- Gelcich, Giuseppe. *Zeta dhe Dinastia e Balshajve*. Përktheu nga origjinali Laura Leka. Tiranë: Shtëpia Botuese "55", 2009.
- Il Codice Morosini. Il mondo visto da Venezia (1094-1433)*. Edizione critica, introduzione, indice e altri apparati di Andrea Nanetti. Tomo Primo. Introduzione e Cronaca-Diario dal 1094 al 1413 (fino a tutto il dogado di Michele Steno). Spoleto: Centro Italiano di Studi sull' Alto Medioevo, 2010.
- Istoria Crne Gore*. Knjiga druga. Od Kraja XII do Kraja XV Vijeka. Tom Drugi: Crna Gora i doba oblasnih gospodara. Titograd: Redakcija za istoriju Crne Gore 1970.
- Jireček, Constantin. *Geschichte der Serben Zweiter Band, erste Hälfte (1371-1537)*. Gotha: Driedrich Andreas Perthes A.-G., 1918.
- Jireček, Konstantin. *Historia e serbëve*. Pjesa e dytë (Gjysma e parë 1371-1537). Përktheu nga gjermanishtja Elda Gjana-Boriçi. Tiranë: Shtëpia Botuese "55", 2010.
- Jireček, Konstantin. "Skutari und sein Gebiet im Mittelalter". In *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot, 1916.
- Lajçi, Lulëzim. *Shkodra në shekullin e XV*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1997.
- Ljubić, Sime. *Listine o odnošajih između južnoga Slavenstva i mletačke republike*. Na sviet uzdaje Jugoslavenska Akademija Znanosti i umjetnosti. Skupio Sime Ljubić. Knjiga IV. Do godine 1358 od 1403. U Zagrebu: Albrechta i Fiedlera 1874.
- Ljubić, Sime. *Opis Jugoslavenskuh Novaca*. Od Prof. Sim Ljubića. Izdanje Umnoženo. Zagreb: Artističko-Tiopgrafičku Zavod Dragutina Albrechta 1875.
- Malaj, Edmond. *Drishti. Historia dhe fizionomia e një qyteti mesjetar shqiptar*. Tiranë: Akademia e Studimeve Albanologjike, 2015.
- Malaj, Edmond. "Përprjekja e dytë e Balshës III gjatë viteve 1408-1421 për rivendosjen e sundimit të tij në Shkodër e rrethina". Në *Hylli i Dritës* 1, 2023.
- Malltezi, Luan. "Shkaqet e luftës së Balshës III kundër Reublikës së Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV". Në *Studime për Epokën e*

- Skënderbeut II*. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë 1989.
- Malltezi, Luan. “Shkaqet e luftës së Balshës III kundër Republikës së Venedikut në 20 vjetët e parë të shek. XV”. Në *Studime historike*, nr. 2, 1980.
- Millutinoviç, Branisllav. “Drishti nën sundimin e Venedikut”. Në *Gjurmime Albanologjike*. Seria e shkencave historike 15-1985, Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1986.
- Orbino, Don Mavro. *Il Regno degli Slavi hoggi corrottamente detti Schiavoni Historia di Don Mavro Orbino Rauseo Abbate Melitense*. Nella qualesi vede l’Origine quasi di tutti i Popoli, che furono della Lingua Slava, con molte, & varie guerre, che fecero in Europa, Asia & Africa il progresso dell’Impero, l’antico culto, & il tempo della loro conversione al Christianesimo. E in particolare veggonsi i successi de’Rè, che antocamente dominarono in Dalmazia, Croatia, Bosna, Servia, Russia, & Bvlgaria. In Pesaro, Appresso Girolamo Concordia. Con Licenza de’Superiori. M.DCI, 1601.
- Radonić, Jovan. “Der Grossvojvode von Bosnien Sandaljs Hranić-Kosač”. Në *Archiv für Slavische Philologie*. Unter Mitwirkung von A. Brückner (Berlin), J. Gebauer (Prag), C. Jireček (Wien), A. Leskien (Leipzig), W. Nehring (Breslau), St. Novakovič (Belgrad), A. Wesselofsky (St. Petersburg). Herausgegeben von V. Jagić. Neunzehnter Band. Berlin: Weidmansche Buchhandlung, 1897.
- Regjistri i Kadastrës dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*. Përgatitur për botim nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. Tiranë: 1977.
- Ruvarac, Hilarion. “Zwei bosnische Königinnen”. In *Wissenschaftliche Mitteilungen aus Bosnien und der Herzegovina*. Herausgegeben vom Bosnisch-Hercegovinischen Landesmuseum in Sarajevo. Redigiert von Dr. Moriz Hoernes. Dritter Band. Mit 16 Tafeln und 1178 Abbildungen im Texte. Wien: 1895.
- Šufflay, Milan von. “Kirchenzustände im vortürkischen Albanien. Die orthodoxe Durchbruchszone im katholischen Damme”. Në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin K. Jireček, Professor Dr. Milan von Šufflay, Sektionsschef Theodor Ippen, Professor E. C. Sedlmayr, Archivar Dr. Josef Ivanič, Weiland Emmerich von Karácson, K. Ung. Sektionsrat Béla Péch und Karl Thopia. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916.
- Theiner, Augustino. *Vetera monumenta historica Hungariam Sacram illustrantia. Maximum partem nondum edita ex tabularis vaticanis*.

Deprompta collecta ac serie chronologica desposita ab Augustino Theiner. Tomus Secundus ab Innocentio PP VI usque ad Clementem PP. VII. 1352-1526. Romae: Typis Vaticanis MDCCCLX, nr. CCCXXIV. 1860.

Valentini, Giuseppe (Zef). *Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë 1060-1560*. Tiranë: Plejad, 2010.

Valentini, At Giuseppe (Zef). *Statuti personal në Shqipërinë në Epokën e Skënderbeut (Shënime nga Arkivat e Republikës Venete)*. Botimi i Parë. Redaktuar nga Ndriçim Kulla dhe Ksenofon Krisafi. Përkthyer nga Dritan Thomollari. Tiranë: Plejad, 2007.

Site:

Tomin, Svetlana, “Jelena Balšić”, URL:

<http://knjizenstvo.etf.bg.ac.rs/en/authors/jelena-balsic> (13.01.2014).

